

“ikubINFO” shpk

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 - 21

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe ortakët e Shoqërisë “ikubINFO” shpk

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë “ikubINFO” shpk (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2016, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2016, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme, për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare, që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.



Teit Gjini
Auditues Ligjor

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2016**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	170,176,189	101,192,000
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	99,124,603	132,699,011
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	65,650,767	12,104,110
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	495,775	196,000
Prodhimi/punime në proces	8	8,062,704	-
Shpenzime të shtyra	9	12,608,417	3,312,211
Total Aktive Afatshkurtra		356,118,455	249,503,332
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	10	13,485,679	10,435,605
Total Aktive Afatgjata		13,485,679	10,435,605
Total Aktive		369,604,134	259,938,937
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	11	31,396,984	16,140,952
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	12	39,945,687	83,864,171
Detyrime tatimore	13	84,641,897	49,476,230
Të tjera detyrime	14	89,320,000	43,832,965
Total Detyrime Afatshkurtra		245,304,568	193,314,318
Detyrime afatgjata			
Total Detyrime Afatgjata		-	-
Totali i Detyrimeve		245,304,568	193,314,318
Kapitali aksionar			
Kapitali i nënshkruar	15	4,200,000	4,200,000
Rezerva ligjore		420,000	420,000
Fitimi i ushtrimit		119,679,566	62,004,619
Total kapitali aksionar		124,299,566	66,624,619
Totali i Kapitalit dhe Detyrimeve		369,604,134	259,938,937

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16	841,644,808	470,444,784
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	17	(263,806)	(824,254)
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(327,834,594)	(181,336,775)
Lënda e parë dhe materiale të			
1) konsumueshme	18	(290,099,831)	(154,309,886)
2) Të tjera shpenzime	19	(37,734,763)	(27,026,889)
Shpenzime të personelit	20	(368,677,581)	(212,447,362)
1) Paga dhe shpërblime		(356,409,105)	(203,602,205)
Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për			
2) pension)		(12,268,476)	(8,845,157)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10	(3,270,590)	(2,416,234)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	21	(11,864)	(5,286)
Të ardhura të tjera		-	-
Shpenzime financiare	22	2,829	77,574
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek			
1) njësitë ekonomike brenda grupit)		2,829	2,970
2) Shpenzime të tjera financiare		-	74,604
Fitimi/humbja para tatimit		141,589,202	73,492,447
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	23	(21,909,636)	(11,487,828)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi			
1) fitimin		(21,909,636)	(11,487,828)
Fitimi/humbja e vitit		119,679,566	62,004,619
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:			
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		0	0
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		119,679,566	62,004,619

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2015	4,200,000	-	-	40,984,535	45,184,535
Fitimi / Humbja e vitit				62,004,619	62,004,619
Lëvizjet përmes kapitalit		420,000	40,564,535	(40,984,535)	-
Dividendë të paguar			(40,564,535)		(40,564,535)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	4,200,000	420,000	-	62,004,619	66,624,619
Fitimi / Humbja e vitit				119,679,566	119,679,566
Lëvizjet përmes kapitalit			62,004,619	(62,004,619)	-
Dividendë të paguar			(62,004,619)		(62,004,619)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	4,200,000	420,000	-	119,679,566	124,299,566

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 janë aprovuar nga administratori i ikubINFO shpk më 10.03.2017 dhe janë firmosur si më poshtë.



Romeo SHERKO
Romeo SHERKO
Administrator

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	119,679,566	62,004,619
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	260,842	606,862
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	11,440,920	4,864,467
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	3,270,588	2,416,235
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(29,568,230)	(114,425,693)
Rënie/(rritje) në inventarë	(8,062,704)	-
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(5,599,283)	111,480,134
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	46,148,611	(763,213)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	137,570,312	66,183,411
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(6,320,662)	(4,707,884)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(6,320,662)	(4,707,884)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Dividendë të paguar	(62,004,619)	(40,564,535)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(62,004,619)	(40,564,535)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	69,245,031	20,910,992
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	101,192,000	80,887,870
<i>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	(260,842)	(606,862)
Mjete monetare dhe ekuivalentë më 31 dhjetor	170,176,189	101,192,000

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "ikubINFO" shpk është regjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar pranë regjistrave të Qendrës Kombëtare të Regjistrimeve më datë 12.05.2011. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr.7638 datë 19 Nëntor 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe statuti i saj.

Kapitali Themeltar i shoqërisë është 4,200,000 Lek i zotëruar nga ortakët si më poshtë:

- Investment SHERKO - ikub GROUP 41.5%
- Armand Shara 28%
- Elton Ropi 15%
- Albano Qojle 15.5%

Administrator i shoqërisë është Z.Romeo Sherko.

Selia e shoqërisë ndodhet në rrugën Abdyl Frasheri, EGT Tower, Pallati 11/1, Tiranë. Ajo është e regjistruar në Degën e Tatimeve, Tiranë më NIPT L11712002T.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie janë: "I. Aktiviteti i zhvillimit të software aplikative. 1.1 Në platforma Net. Java, Web Assembler.1.2 Në fushën e Taksave, Content Management, Portale, Interoperabilitet, e të tjera të përafërta. Aktiviteti i shërbimeve mbi software aplikative të zhvilluara nga vetë Shoqëria ikubInfoSoft, ose software të tjera ku ka kompetencë.3. Aktiviteti i implementimit të sistemeve Database, Middleware, BI, Data Warehouse dhe platformave që shërbejnë për zhvillime aplikacionesh, objekt i veprimtarisë së ikubInfoSoft shpk. 4. Trajnime dhe Kurse të Formimit Profesional për çdo specialitet që lidhet me aktivitetet e ikubINFO shpk. 5. Aktiviteti i konsulencës në fushën e software aplikativë. 6. Aktiviteti i Solution Design për software aplikative. 7. Aktiviteti i Manaxhimit të Projekteve me komponentë që bëjnë pjesë në pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6. 8. Aktiviteti i Manaxhimit të Projekteve me objekt ICT. 9. Aktiviteti i shitjes së produkteve dhe shërbimeve që ka në objektin e veprimtarisë. 10. Aktiviteti i shitjes së pajisjeve ICT. II. Aktiviteti i shitjes së licencave software dhe shërbimeve përkatëse të lidhura me to. 12. Software si shërbim. 13. Aktivitet në shërbime të adoptimit dhe të përshtatjes së softwareve. 14. Aktivitet në shërbime të përpunimit të të dhënave. 15. Aktivitet në shërbime të hostimit të bazave të të dhënave dhe të dhënave përkatëse. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar ikubInfoSoft sh.p.k zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. 16. Dizajn, programim, zhvillim, konsulencë, shërbime dhe veprimtari në fushën e aplikimeve GIS dhe WebGIS, punime hartografike, topografike, dhe fotogrametrike, menaxhim i fotove ajrore dhe ortofotove, rrjetet e infrastrukturës, pasuri të paluajtshme, prodhim dhe menaxhim i informacioneve gjeografike dixhitale të të gjitha tematikave, strukturim dhe krijim i bazave të të dhënave hapësinore, zhvillime analizash".

Më 31 dhjetor 2016 Shoqëria kishte 80 punonjës (2015: 53 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr. 9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr.64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshëm zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme, të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve, janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar, të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në ç'regjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual, si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%. Në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit, e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahaseshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale, me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit të monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2016	2015
Euro/Lek	135.23	137.28
USD/ Lek	128.17	125.79

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare, instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiar ç'regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare ç'regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë, të skontuara me normën efektive të interesit.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2 Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar, duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes, duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përfaqësohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiar të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet të tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiar të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2016 dhe 2015 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyrën	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %

iv. Ç’regjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale ç’regjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritjeje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15% (2015: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.11 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13 Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si

provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Mjete monetare në bankë	170,059,421	101,087,672
Llogari rrjedhëse	170,059,421	101,087,672
Mjete monetare në arkë	116,768	104,328
	<u>170,176,189</u>	<u>101,192,000</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Klientë	99,124,603	132,699,011
	<u>99,124,603</u>	<u>132,699,011</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Të arkëtueshme tregtare nga Infosoft System shpk	65,650,767	12,104,110
	<u>65,650,767</u>	<u>12,104,110</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Paradhënie për shpenzime	28,398	-
Garanci për qera	98,000	196,000
Rimbursime nga Sig. Shoqërore	369,377	-
	<u>495,775</u>	<u>196,000</u>

8. Punime në proces

Gjendjet e punimeve në proces më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 janë si më poshtë :

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Kostot e punimeve , (përfshire TVSH 20%)	8,062,704	-
	<u>8,062,704</u>	<u>-</u>

Punime në proces përfaqëson punën e kryer ende të pafaturuar ndaj klientit. Sipas Legjislacionit shqiptar, TVSH-ja prej 20% aplikohet edhe për prodhimin në proces, edhe për parapagimet.

9. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet për periudhat e ardhshme më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë si më poshtë :

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Shpenzime të periudhave të ardhshme për sigurim shëndetsor	2,120,166	3,312,211
Shërbim suporti për vitin 2017	4,974,650	-
Suport për planin strategjik të ndërmarrjes për vitin 2017	5,491,062	-
Parapagime	22,539	-
	<u>12,608,417</u>	<u>3,312,211</u>

“ikubINFO” shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

10. Aktive Afatgjata Materiale

	Mobilje orendi	Pajisje kompjuterike	Të tjera	Totali
Kosto				
Gjendja më 1 Janar 2015	1,671,475	10,406,247	1,917,456	13,995,178
Shtesa	736,730	3,075,685	895,469	4,707,884
Pakësime	-	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	2,408,205	13,481,932	2,812,925	18,703,062
Shtesa	1,366,779	4,745,175	208,710	6,320,664
Pakësime	-	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	3,774,984	18,227,107	3,021,635	25,023,726
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 1 Janar 2015	(352,263)	(4,609,892)	(889,067)	(5,851,222)
Amortizimi i vitit	(344,610)	(1,754,487)	(317,138)	(2,416,235)
Rimarje e Amortizimit	-	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	(696,873)	(6,364,379)	(1,206,205)	(8,267,457)
Amortizimi i vitit	(549,130)	(2,370,352)	(351,108)	(3,270,590)
Rimarje e Amortizimit	-	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	(1,246,003)	(8,734,731)	(1,557,313)	(11,538,047)
Vlera neto kontabël				
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	1,319,212	5,796,355	1,028,389	8,143,956
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	1,711,332	7,117,553	1,606,720	10,435,605
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	2,528,981	9,492,376	1,464,322	13,485,679

11. Llogari të pagueshme tregtare

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj furnitorëve për faturat e pranuar dhe ato të pambërritura. Më poshtë janë paraqitur këto detyrime më 31 dhjetor 2016 dhe 2015:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Furnitorë	31,315,114	16,096,439
Furnitorë për fatura të pambërritura	81,870	44,513
	<u>31,396,984</u>	<u>16,140,952</u>

12. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
IT Panakeia / ikubINFO Software Solutions	9,992,732	-
ikub.al	10,520,000	10,120,000
Infosoft Systems Shpk	7,032,955	72,904,171
Investment Sherko - ikub Group	12,400,000	-
Romeo Sherko	-	840,000
	<u>39,945,687</u>	<u>83,864,171</u>

13. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	1,985,045	1,469,331
Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi	38,447,075	19,102,320
Tatim në Burim	1,881,207	2,816,405
Tatim fitimi	11,440,920	3,996,394
TVSH për t'u paguar	30,887,650	22,091,780
	<u>84,641,897</u>	<u>49,476,230</u>

14. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve dhe detyrime të tjera më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Detyrime ndaj personelit	89,320,000	43,171,389
Përfitime afatshkurtra nga sigurimet	-	49,375
Detyrime të tjera	-	612,201
	<u>89,320,000</u>	<u>43,832,965</u>

15. Kapitali

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 4,200,000 Lek i zotëruar si më poshtë:

Ortakut	31 dhjetor 2016		31 dhjetor 2015	
	Kuota %	Vlera	Kuota%	Vlera
Investment				
SHERKO	41.5	1,743,000	41.5	1,743,000
Armand Shara	28	1,176,000	28	1,176,000
Elton Ropi	15	630,000	15	630,000
Albano Qojle	15.5	651,000	15.5	651,000
Totali	100	4,200,000	100	4,200,000

16. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Të ardhura nga shitja e materialeve	18,038,516	83,497,706
Të ardhura nga shërbimet	823,606,292	386,947,078
	841,644,808	470,444,784

17. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar, të cilat detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Fitime nga këmbimet valutore	615,640	418,653
Humbje nga këmbimet valutore	(903,446)	(1,242,907)
Të ardhura të tjera	24,000	-
	(263,806)	(824,254)

17. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit (vazhdim)

Rakordimi i të ardhurave të deklaruar në FDP e Tatim Fitimit me xhiron e deklaruar në FDP e TVSH është si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Shitje totale të deklaruar në FDP TVSH	841,644,808
Shitje të deklaruar në FDP që janë të ardhura në PASH	841,644,808
Shitje mallrash	18,038,516
Shërbime	822,636,068
Të ardhura të tjera	970,224
Të ardhura të deklaruar në PASH të cilat janë deklaruar shitje në FDP	841,644,808
Fitime nga gabime të lejuara në ushtrimet paraardhëse	
Të ardhurat nga interesat	2,829
Të ardhura të tjera financiare	24,000
Fitim nga këmbimet valutore	615,640
Total të ardhura të deklaruar FDP e Tatim Fitimit	842,287,277

18. Lëndët e para dhe shërbimet

Shërbimet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe atë të mbyllur më 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Shërbime programimi	185,852,053	45,024,454
Shërbime mirëmbajtjeje	86,406,833	29,201,562
Licensa	-	120,883
Kosto e materialeve të shitura	17,840,945	79,962,987
	290,099,831	154,309,886

19. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Blerje energji, ujë	1,581,923	823,551
Shpenzime komunikimi	735,359	615,520
Reklama, publicitet	433,519	223,059
Konsulencë juridike, ekonomike	332,333	746,337
Siguracione	4,872,775	2,834,906
Shpenzime administrative noteriale	582,391	453,765
Taksa vendore	198,316	33,573
Mirëmbajtje ambiente, pajisje	2,256,379	2,351,954
Qira zyre	13,927,303	9,250,619
Udhëtime dhe dieta	2,844,667	1,056,435
Kancelari	499,378	332,187
Komisione bankare	471,016	358,217
Trajnime punonjësish dhe certifikime	1,421,227	748,960
Sponsorizime	1,518,111	2,422,990
Shpenzime për pritje	97,473	282,443
Shpenzime transporti	355,150	330,645
Qera makina	-	1,870,588
Shërbim ruajtje objekti	410,000	-
Garanci kontrate	804,527	-
Certifikime	319,800	490,000
Shpenzime të ndryshme dhe të panjohura	4,073,116	1,801,140
	37,734,763	27,026,889

20. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Shpenzime për paga	356,409,105	203,602,205
Shpenzime për sigurime shoq e shend	12,268,476	8,845,157
	368,677,581	212,447,362

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2016 është 80 (2015: 53).

21. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjokat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015</u>
Gjoka dhe penalitete	11,866	5,286
	<u>11,866</u>	<u>5,286</u>

22. Shpenzime financiare Neto

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015</u>
Të ardhura nga interesat	2,829	2,987
Shpenzime Financiare	-	(17)
Të ardhura të tjera financiare	-	74,604
	<u>2,829</u>	<u>77,574</u>

23. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2015:15%). Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruar për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Fitimi para tatimit	141,589,202	73,492,447
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	4,475,039	3,093,070
Sponsorizime mbi normën e lejuar		218,217
Shpenzime pritje & përcjellje	97,473	282,443
Shpenzime udhëtimi	44,998	23,093
Penalitet, gjoka e dëmshpërblime	11,866	5,285
Shpenzime të tjera pa dokumenta	<u>4,320,702</u>	<u>2,564,032</u>
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	146,064,241	76,585,517
	146,064,241	76,585,517
Tatim fitimi @15%	21,909,636	11,487,828
Fitimi/humbja e Vitit	<u>119,679,566</u>	<u>62,004,619</u>

24. Transaksionet me palët e lidhura

“ikubINFO” shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Vlerat janë në Lek)

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

Pasqyra e pozicionit financiar

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Te arketueshme nga palet e lidhura		
Infosoft Systems Shpk	65,650,767	12,104,110
	65,650,767	12,104,110
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura		
IT Panakeia / ikubINFO Software Solutions	9,992,732	-
ikub.al	10,520,000	10,120,000
Infosoft Systems Shpk	7,032,955	72,904,171
Investment Sherko - ikub Group	12,400,000	-
Romeo Sherko	-	840,000
	39,945,687	83,864,171

Pasqyra e performancës

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015</u>
Shitje ndaj palëve e lidhura		
Infosoft System shpk	138,777,545	19,136,234
	138,777,545	19,136,234
Blerje nga palët e lidhura		
IT Panakeia / ikubINFO Software Solutions	37,716,340	8,907,119
InfoSoft Systems	47,613,253	100,449,134
ikub.al	32,288,589	9,109,726
Investment Sherko - ikub Group	22,000,000	-
Armand Shara	4,395,501	2,442,223
Romeo Sherko	4,908,431	3,081,569
Elton Ropi	1,376,979	976,889
Albano Qojle	2,473,920	1,465,334
	152,773,013	126,431,994

Politika e vendosjes së çmimeve për transaksionet me palët e lidhura bëhet në bazë të kushteve të tregut.

25. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2016 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

26. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Mazars Sh.p.k

Adresa

Rruga Emin Duraku, Pall. "Binjaket", Nr.5

Tirane, Shqiperi

Tel. +355 (0) 42 278 015

audit@mazars.al

www.mazars.al